

**Rregullorja (KE) nr. 1643/2003 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 22 korrik 2003, që ndryshon Rregulloren (KE) nr. 1592/2002, për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe themelimin e një Agjencie Europiane për Sigurinë e Aviacionit**

*Gazeta Zyrtare L 245 , 29/09/2003 fq. 0007 – 0009.*

Rregullorja (KE) nr. 1643/2003 e Parlamentit Europian dhe e Këshillit, datë 22 korrik 2003, që ndryshon Rregulloren (KE) nr. 1592/2002, për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe themelimin e një Agjencie Europiane për Sigurinë e Aviacionit.

**PARLAMENTI EUROPIAN DHE KËSHILLI I BASHKIMIT EUROPIAN**

Duke pasur parasysh Traktatin Themelues të Komunitetit Europian dhe veçanërisht nenin 80 pika 2 të tij.

Duke pasur parasysh propozimin e Komisionit [1].

Duke pasur parasysh mendimin e Gjykatës së Auditëve [2].

Duke pasur parasysh mendimin e Komitetit Europian Ekonomik dhe Social [3].

Duke vepruar në përputhje me procedurën e parashikuar në nenin 251 të Traktatit [4].

Duke pasur parasysh se:

(1) Disa dispozita të Rregullores (KE) nr. 1592/2002 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 15 korrik 2002, mbi rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe themelimin e një Agjencie Europiane për Sigurinë e Aviacionit [5] duhet të sillen në linjë me Rregulloren e Këshillit (KE, Euratom) nr. 1605/2002, datë 25 qershor 2002, për Rregulloren Financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Komuniteteve Europiane [6] (më poshtë Rregullorja e Përgjithshme Financiare) dhe, veçanërisht, nenin 185 i saj.

(2) Parimet e përgjithshme dhe kufijtë që rregullojnë ushtrimin e së drejtës për t'u njohur me dokumentet, të parashikuara në nenin 255 të Traktatit, janë përcaktuar në Rregulloren (KE) nr. KE 1049/2001 të Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 30 maj 2001, në lidhje më të drejtën e publikut për t'u njohur me dokumentet e Parlamentit Europian, Këshillit dhe Komisionit [7].

(3) Kur Rregullorja (KE) nr. 1049/2001 u miratua, të tre institucionet ranë dakord përmes një deklaratë të përbashkët ku agjencitë dhe organet e ngjashme duhet të kenë rregulla, të cilat përputhen me ato të kësaj Rregulloreje.

(4) Për rrjedhojë, dispozita të përshtatshme duhet të përfshihen në Rregulloren (KE) nr. 1592/2002, për ta bërë Rregulloren (KE) nr. 1049/2001 të zbatueshme për Agjencinë Europiane për Sigurinë e Aviacionit, sikurse duhet një dispozitë për apelimet ndaj një refuzimi të njohjes me dokumente.

(5) Rregullorja (KE) nr. 1592/2002, duhet të ndryshohet rrjedhimisht,

**KANË MIRATUAR KËTË RREGULLORE:**

Neni 1

Rregullorja (KEE) nr. 1592/2002 ndryshohet si më poshtë vijon:

1. Neni 24 pika 2 germa (b) zëvendësohet nga sa vijon:

"(b) Bordi Drejtues miraton raportin vjetor të aktiviteteve të agjencisë dhe ia përcjell jo më vonë se data 15 qershor Parlamentit Europian, Këshillit, Komisionit dhe Gjykatës së Auditeve dhe Shteteve Anëtare. Agjencia i përcjell çdo vit autoritetit buxhetor çdo informacion që ka lidhje me rezultatet e procedurave të vlerësimit":

2. Në nenin 47:

(a) paragrafi 1, zëvendësohet nga sa vijon:

"1. Rregullorja (KE) nr. 1049/2001 e Parlamentit Europian dhe Këshillit, datë 30 maj 2001, në lidhje më të drejtën e hyrjes në dokumentet e Parlamentit Europian, Këshillit dhe Komisionit [8] zbatohet për dokumentet që mbahen nga Agjencia";

(b) paragrafi 3 zëvendësohet nga sa vijon:

"3. Bordi Drejtues miraton masat për zbatimin e Rregullores (KE) nr. 1049/2001 brenda 6 muajsh pas hyrjes në fuqi të Rregullores (KE) nr. 1643/2003 të Parlamentit Europian dhe të Këshillit, datë 22 korrik 2003 që ndryshon Rregulloren (KE) nr. 1592/2002, datë 15 korrik 2002, për rregullat e përbashkëta në fushën e aviacionit civil dhe themelimin e një Agjencie Europiane për Sigurinë e Aviacionit [9]";

(c) paragrafi i mëposhtëm shtohet:

"5. Vendimet e marra nga Agjencia në zbatim të nenit 8 të Rregullores (KE) nr. 1049/2001 mund t'i hapin rrugën depozitimit të një ankese për Avokatin e Popullit ose formojnë lëndën e një veprimi përpara Gjykatës së Drejtësisë, përkatësisht sipas neneve 195 dhe 230 të Traktatit të KE-së".

3. Në nenin 48:

(a) paragrafët 3, 4, 5, 6 dhe 7 zëvendësohen nga sa vijon:

"3. Të ardhurat dhe shpenzimet duhet të jenë të balancuara.

4. Çdo vit Bordi Drejtues, mbi bazën e një projektbilanci të parashikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, prodhon një bilanc të parashikimit të të ardhurave dhe shpenzimeve të agjencisë për vitin financiar pasardhës.

5. Ky bilanc i parashikimit, i cili përfshin një plan të përkohshëm organizues të shoqëruar nga programi paraprak i punës, duhet t'i përcillet nga Bordi Drejtues, jo më vonë se 31 marsi, Komisionit dhe shteteve me të cilat Komuniteti ka lidhur marrëveshje në përputhje me nenin 55.

6. Bilanci i parashikimit i përcillet Parlamentit Europian dhe Këshillit (quajtur më poshtë autoriteti buxhetor), nga Komisioni, bashkë me një projektbuxhet të përgjithshëm paraprak të Bashkimit Europian.

7. Mbi bazën e bilancit të parashikimit, Komisioni fut në projektbuxhetin e përgjithshëm paraprak të Bashkimit Europian parashikimet që i quan të nevojshme për planin organizues dhe shumën e subvencionit që do t'i shtohet buxhetit të përgjithshëm, të cilin e vendos para autoritetit buxhetor në përputhje me nenin 272 të Traktatit";

(b) paragrafët e mëposhtëm shtohen:

"8. Autoriteti buxhetor autorizon caktimin e fondeve për subvencion për Agjencinë.

Autoriteti buxhetor miraton planin organizues për Agjencinë.

9. Buxheti miratohet nga Bordi Drejtues. Ai bëhet përfundimtar pas miratimit të fundit të buxhetit të përgjithshëm të Bashkimit Europian. Kur të jetë e përshtatshme, ai do të përshtatet për rrjedhojë.

10. Bordi Drejtues, sa më shpejt të jetë e mundur, njofton autoritetin buxhetor për qëllimin e tij për të zbatuar çdo projekt, i cili mund të ketë ndikime financiare të mëdha për financimin e buxhetit, në veçanti çdo projekt në lidhje me pronën, të tillë si marrja me qira ose shitja e ndërtesave. Ai njofton Komisionin për këtë.

Kur një degë e autoritetit buxhetor ka njoftuar për qëllimin e saj për të dhënë një mendim, ajo ia përcjell mendimin e saj Bordit Drejtues brenda një periudhe prej gjashtë javësh nga data e njoftimit të projektit".

4. Neni 49 zëvendësohet nga sa vijon:

"Neni 49

Zbatimi dhe kontrolli i buxhetit

1. Drejtori Ekzekutiv zbaton buxhetin e Agjencisë.

2. Jo më vonë se data 1 mars pas çdo viti financiar, financieri i Agjencisë i komunikon financiarit të Komisionit llogaritë e përkohshme bashkë me një raport të drejtimit buxhetor dhe financiar për atë vit

financiar. Financieri i Komisionit konsolidon llogaritë e përkohshme të institucioneve dhe organeve të decentralizuara në përputhje me nenin 128 të Rregullores së Përgjithshme Financiare.

3. Jo më vonë se data 31 mars pas çdo viti financiar, financieri i Komisionit i përcejll llogaritë e përkohshme tek Agjencia e Gjykatës së Auditëve, të shoqëruara nga një raport mbi drejtimin buxhetor dhe financiar për atë vit financiar. Raporti mbi drejtimin buxhetor dhe financiar për atë vit financiar i përcillet gjithashtu Parlamentit European dhe Këshillit.

4. Me marrjen e vërejtjeve të Gjykatës së Auditëve mbi llogaritë e përkohshme të Agjencisë, sipas nenit 129 të Rregullores së Përgjithshme Financiare, Drejtori Ekzekutiv harton llogaritë përfundimtare të Agjencisë nën përgjegjësinë e tij dhe i dorëzon ato për mendim te Bordi Drejtues.

5. Bordi Drejtues jep një mendim mbi llogaritë përfundimtare të Agjencisë.

6. Drejtori Ekzekutiv, jo më vonë se data 1 korrik pas çdo viti financiar, i përcejll llogaritë përfundimtare Parlamentit European, Këshillit, Komisionit dhe Gjykatës së Auditëve, të shoqëruara me mendimin e Bordit Drejtues.

7. Llogaritë përfundimtare botohen.

8. Drejtori Ekzekutiv i dërgon Gjykatës së Auditëve një përgjigje për vërejtjet e saj jo më vonë se data 30 shtator. Ai ia dërgon këtë përgjigje edhe Bordit Drejtues.

9. Drejtori Ekzekutiv i dorëzon Parlamentit European, me kërkesë të këtij të fundit, çdo informacion të nevojshëm për zbatimin gradual të procedurës së lejes për vitin financiar në fjalë, siç parashtrahet në nenin 146 pika 3 të Rregullores së Përgjithshme Financiare.

10. Parlamenti European, me një rekomandim nga Këshilli, që vepron me një shumicë të cilësuar, përpara datës 30 prill të vitit  $n + 2$ , i jep leje Drejtorit Ekzekutiv në lidhje me zbatimin e buxhetit për vitin n”.

5. Neni 52 zëvendësohet nga sa vijon:

"Neni 52

Dispozitat Financiare

Rregullat financiare të zbatueshme për Agjencinë miratohen nga Bordi Drejtues, pasi të jetë këshilluar me Komisionin. Ato nuk mund të nisen nga Rregullorja e Komisionit (KE, Euratom) nr. 2343/2002, datë 19 nëntor 2002, mbi Rregulloren Financiare kuadër për organet e përmendura në nenin 185 të Rregullores së Këshillit (KE, Euratom) nr. 1605/2002 mbi Rregulloren Financiare të zbatueshme për buxhetin e përgjithshëm të Komuniteteve Europiane [10], vetëm nëse një nisje e tillë kërkohet në mënyrë të posaçme për funksionimin e Agjencisë dhe Komisioni ka dhënë miratimin e mëparshëm të tij.”

Neni 2

Kjo rregullore hyn në fuqi në ditën e parë të muajit që vijon botimin e saj në Gazetën Zyrtare të Bashkimit European.

Kjo rregullore është e detyrueshme në tërësinë e saj dhe drejtpërdrejt e zbatueshme në të gjitha Shtetet Anëtare.

Nënshkruar në Bruksel, më 22 korrik 2003.

Për Parlamentin European

Presidenti

**P. Cox**

Për Këshillin

Presidenti

**G. Alemanno**

[1] GZ C 331 E, 31.12.2002, fq. 85.

[2] GZ C 285, 21.11.2002, fq. 4.

[3] GZ C 85, 08.04.2003, fq. 64.

[4] Mendimi i Parlamentit European, datë 22 tetor 2002 (ende i pabotuar në Gazetën Zyrtare), Qëndrimi i Përbashkët i miratuar nga Këshilli më 3 qershor 2004 (ende i pabotuar në Gazetën Zyrtare) dhe Vendimi i Parlamentit European, datë 1 korrik 2003.

[5] GZ L 240, 07.09.2002, fq. 1.

[6] GZ L 248, 16.09.2002, fq. 1; korrigjim i GZ L 25, 30.01.2003, fq. 43.

[7] GZ L 145, 31.05.2001, fq. 43.

[8] GZ L 145, 31.05.2001, fq. 43.

[9] GZ L 245, 29.09.2003, fq. 7.

[10] GZ L 357, 31.12.2002, fq. 72; korrigjim i GZ L 2, 07.01.2003, fq. 39.